

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rritja e inflancionit, Sejko: Kemi ruajtur një kuadër të qartë të politikës monetare, arritje anëtarësimi i Shq ipërisë në SEPA – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/rritja-e-inflancionit-sejko-kemi-ruajtur-nje-kuader-te-qarte-t-e-politikes-monetare-arritje-anetaresimi-i-shqiperise-ne-sepa/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 23:08:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 08:33:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bed5f2728e66aa14c71b5676626522a58ccba09b6e4bac0e554bd07aeee4cdda
TEKSTI	237ef21f73b812df7755eb6aec53254b9cf27bc745d78827c6852abb23342f26
PAMJA	e0d6e3febaf9cfa158c8ecdd34e98b0adc27c71e5dd1124f5b3369cfd6ab5c76

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	debba941509161edb91391a0d7e85f3a51f5c8dfe0d34f3b8ea425e28b3ca153
E MËPARSHMJA	7d05dc8981dc1eceab90e9da5da3ba99200c8817188c57c7392b017f65eaf7d5
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/debba941509161edb91391a0d7e85f3a51f5c8dfe0d34f3b8ea425e28b3ca153>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Ilustrim · Vizion Plus

Më 3-4 shtator 2026, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, mori pjesë në konferencën e nivelit të lartë, të organizuar nga Banka Qendrore e Malit të Zi me rastin e 25-vjetorit të themelimit të saj. Konferenca mbledhi guvernatorë të bankave qendrore dhe ekspertë të nivelit të lartë për të diskutuar sfidat me të cilat përballen aktualisht bankat qendrore, në një mjedis të karakterizuar nga zhvillime komplekse dhe pasiguri.

Guvernatori Sejko ishte ftuar si folës në panelin me temë “Besueshmëria, hapësira e politikës monetare dhe përafrimi me BE-në në një mjedis sfidues”, së bashku me guvernatorët e Bankës Qendrore të Bosnjë-Hercegovinës, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Bankës Qendrore të Malit të Zi dhe Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në fjalën e tij, Guvernatori Sejko theksoi rëndësinë e besueshmërisë së bankave qendrore, duke e vlerësuar atë si një element thelbësor për forcimin e institucioneve dhe për zbatimin sa më efektiv të politikës monetare.

Përvoja e viteve të fundit ka dëshmuar rolin thelbësor të besueshmërisë për ankimimin e pritjeve, ruajtjen e besimit dhe mbështetjen e stabilitetit makroekonomik përballë goditjeve të njëpasnjëshme. Ai nënvizoi se besimi ndërtohet mbi një kuadër të fortë institucional, politika të qëndrueshme dhe komunikim të qartë, transparent dhe efektiv me publikun.

Duke iu referuar përvojës së Bankës së Shqipërisë, Guvernatori theksoi rëndësinë e ruajtjes së një kuadri të qartë të politikës monetare, të

5 Viti i shkollor nis edhe në Burgun e Korçës, 31 të dhënuar ndjekin...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

ankoruar në regjimin e shënjestrimit të inflacionit dhe të mbështetur nga një regjim fleksibël i kursit të këmbimit. Ai veçoi gjithashtu reformat e ndërmarra për forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit financiar, përfshirë përmirësimin e mjedisit të kreditimit dhe modernizimin e infrastrukturës së pagesave, pjesë e të cilit është edhe anëtarësimi i Shqipërisë në SEPA. Një tjetër temë e diskutuar ishte përafrimi me kuadrin rregullativ të Bashkimit Evropian dhe ruajtja e stabilitetit makroekonomik e financiar gjatë procesit të reformave. Guvernatori Sejko theksoi se integrimi evropian dhe përmbushja e mandateve të bankave qendrore për ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar plotësojnë njëri-tjetrin. Harmonizimi me standardet e BE-së kontribuon gjithashtu në forcimin e efektivitetit të politikave të ndërmarra nga bankat qendrore.

Në këtë drejtim, Guvernatori evidentoi disa prej prioriteteve të Bankës së Shqipërisë në procesin e përafrimit me standardet evropiane. Ndër to, ai renditi harmonizimin e kuadrit ligjor me atë të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, përafrimin e kuadrit mbikëqyrës dhe rregullator me standardet Basel III dhe me praktikat më të mira të BE-së, si dhe modernizimin e infrastrukturës financiare. Guvernatori theksoi se anëtarësimi në SEPA përbën një hap të rëndësishëm për integrimin e mëtejshëm të vendit në infrastrukturën financiare evropiane.

Ai nënvizoi gjithashtu rëndësinë e zbatimit të platformës TIPS Clone, i cili është një klonim i sistemit evropian të pagesave të shpejta (instant payments) që do të krijojë kursime si në kohë, ashtu edhe në para, për të gjithë konsumatorët, individët dhe bizneset shqiptare dhe pritet të implementohet në vendin tonë deri në fund të këtij viti.

Guvernatori Sejko zhvilloi gjithashtu një takim me z. Mateusz Szczurek, Drejtor i Departamentit Evropian pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Gjatë takimit u shkëmbyen pikëpamje mbi zhvillimet ekonomike dhe financiare në rajon, procesin e integritit evropian dhe sfidat që shoqërojnë atë.

Në kuadër të pjesëmarrjes në këtë aktivitet, Guvernatori Sejko zhvilloi edhe një sërë takimesh dypalëshe me përfaqësues të FMN-së dhe me guvernatorë të bankave të tjera qendrore, ku u diskutua mbi çështje me interes të përbashkët dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

#bankaeshqiperise

#Sejko



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



EKONOMI

**"Ekonomia" diskuten
pagat në drejtësi,...**

Xhuljana
Zhuleku

Dje
20:38



EKONOMI

**Nafta "kapërcen" 230
lekë për litër,...**

Xhuljana
Zhuleku

Dje
11:53



EKONOMI

**Kërkohe më shumë
kredi për shtëpi,...**

Xhuljana
Zhuleku

13
Sht



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Kujeta

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Engjere

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.